



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
**Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë**

Tiranë, më 1.8.2024

**Njoftim për 2 (dy) pozicione të lira  
pune**

Në zbatim të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Statutit të saj, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.821, datë 28.12.2023 për “Ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Kryesisë të Akademisë së Shkencave nr.4, datë 10.01.2024 “Për strukturën e organikën dhe për emërimin e punonjësve kërkimorë-shkencorë dhe të administratës ndihmëse të instituteve të albanologjisë” dhe të Rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave, e ndryshuar, shpall pozicionet për dy vende të lira pune:

- 1. Pozicioni: Punonjës kërkimor-shkencor, në Departamentin e Gramatikës dhe Historisë së gjuhës, me fushë kërkimi: Studime në gramatikë historike, “Doktor i Shkencave”- B2.**
- 2. Pozicioni: Punonjës kërkimor-shkencor, në Departamentin e Studimeve Letrare, me fushë kërkimi: Studime mbi letërsinë shqipe me alfabet oriental, (njohur ndryshe me alfabet arab) “Doktor i Shkencave”- B2.**

Pozicionet e punës janë pranë *Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë* në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

- Kandidati/ja që aplikon për vendin e punonjës kërkimor-shkencor, në Departamentin e Gramatikës dhe Historisë së gjuhës, me fushë kërkimi: Studime në gramatikë historike, “Doktor i Shkencave”-B2, pranë Akademisë së Shkencave duhet të plotësojë *kriteret e përgjithshme* dhe *kriteret e veçanta*, të cilat janë parashtruar në këtë dokument, deri në miratimin e akteve të tjera nënligjore.

### **Kritere të përgjithshme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
7. Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimdhënësit (vetëdeklarim ose vërtetim);
8. Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë.

Pranohen vetëm kandidatët të cilët, përveç kriterëve të përgjithshme, plotësojnë edhe kriteret e veçanta, si më poshtë:

### **Kriteret e veçanta:**

1. Kandidati duhet të ketë së paku gradën shkencore “Doktor në studimet gjuhësore”;
2. Të jetë njohës i mirë i traditës studimore mbi historinë e shqipes dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera, si dhe i studimeve për gramatikën e saj historike;
3. Kontribute shkencore botuese: monografi, artikuj e studime të tipologjive të tjera shkencore mbi këtë fushë studimore;
4. Kontribute shkencore kumtuese: pjesëmarrje në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare me kumtime në këtë fushë;

5. Të zotërojë me dëshminë përkatëse të paktën njërën prej gjuhëve të lashta: latinishte ose greqishte e vjetër, si dhe ndonjë prej gjuhëve ballkanike me peshë në studimet historiko-krahasuese ose të ketë kryer shkollim në një prej këtyre gjuhëve;

6. Të ketë një projekt pune disavjeçar për studime për një çështje, grup çështjesh etj., nga fusha e gramatikës historike të shqipes;

7. Të ketë aftësi të mira për të punuar në grup me punonjës të Departamentit të Gramatikës dhe të Historisë së gjuhës, të Institutit, si dhe me bashkëpunëtorë jashtë institucionit.

### ***Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati:***

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit të Akademisë së Shkencave, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

- 1. Kërkesën me shkrim;*
- 2. Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit.*
- 3. Curriculum Vitae, me të dhënat personale e profesionale (ku të përfshihet edhe lista e plotë e botimeve, me një përshkrim 4-6 rreshta për çdo botim shkencor).*
- 4. Fotokopjt e noterizuar e diplomës universitare me drejtim gjuhësor e letrar e grades shkencore, si dhe e titullit/titujve akademikës (nëse ka), të fituar Brenda a jashtë vendit (në rastin e fundit, ekuivalentuar ose në proces ekuivalentimi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit).*
- 5. Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së gjuhës ose gjuhëve ndërkombëtare që zotëron ( këtu përfshihen: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht). Për kandidatët që e kanë kryer shkollimin jashtë vendit, mjafton diploma e noterizuar e universitetit të hua).*
- 6. Dy rekomandime nga dy specialistë të fushës.*
- 7. Letër motivimi (1-2 faqe), me të cilën kandidati tregon arsyet e kandidimit dhe nivelin e përgatitjes së tij për postin në të cilin aplikon.*

- Kandidati/ja që aplikon për vendin e punonjës kërkimor-shkencor, në Departamentin e Studimeve Letrare, me fushë kërkimi: Studime mbi letërsinë shqipe me alfabet oriental, (njohur ndryshe me alfabet arab) “Doktor i Shkencave”- B2, pranë Akademisë së Shkencave, e emërtuar dhe si letërsi me alfabet arab, që reflektohet në krijime të një tipologjie të veçantë, të trajtuar në historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe në atë të shkrimit shqip e që përfaqëson veçanti dhe në pikëpamje modeli të përpilimit të tekstit letrar, kryesisht poetik, duhet të plotësojë *kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta*, të cilat janë parashtruar në këtë dokument, deri në miratimin e akteve të tjera nënligjore.

### **Kritere të përgjithshme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
7. Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimdhënësit (vetëdeklarim ose vërtetim);
8. Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë.

Pranohen vetëm kandidatët të cilët, përveç kriterëve të përgjithshme, plotësojnë edhe kriteret e veçanta, si më poshtë:

### **Kriteret e veçanta:**

1. Kandidati duhet të ketë së paku gradën shkencore “Doktor në studimet letrare”;
2. Të jetë njohës i mirë i traditës studimore mbi letërsinë shqipe me alfabet oriental (autorë, vepra, studime);
3. Kontribute shkencore botuese: artikujsh e studimesh mbi këtë fushë studimore;

4. Kontribute shkencore kumtuese: pjesëmarrje në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare me kumtime në këtë fushë;

5. Të jetë njohës i mirë i një gjuhe orientale, si turqishte apo osmanishte;

6. Të ketë një projekt pune disavjeçar mbi letërsinë shqipe me alfabet oriental, të ndërlidhur me çështje të historisë së letërsisë së shkruar shqipe;

7. Të ketë aftësi për të punuar në grup, me punonjës të Departamentit të Studimeve letrare dhe me bashkëpunëtorë jashtë institucionit.

### ***Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati:***

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

1. *Kërkesën me shkrim;*
2. *Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit.*
3. *Curriculum Vitae, me të dhënat personale e profesionale (ku të përfshihet edhe lista e plotë e botimeve, me një përshkrim 4-6 rreshta për çdo botim shkencor).*
4. *Fotokopjt e noterizuar e diplomës universitare me drejtim gjuhësor e letrar e grades shkencore, si dhe e titullit/titujve akademikës (nëse ka), të fituar Brenda a jashtë vendit (në rastin e fundit, ekuivalentuar ose në proces ekuivalentimi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit).*
5. *Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së gjuhës ose gjuhëve ndërkombëtare që zotëron ( këtu përfshihen: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht). Për kandidatët që e kanë kryer shkollimin jashtë vendit, mjafton diploma e noterizuar e universitetit të hua).*
6. *Dy rekomandime nga dy specialistë të fushës.*
7. *Letër motivimi (1-2 faqe), me të cilën kandidati tregon arsyet e kandidimit dhe nivelin e përgatitjes së tij për postin në të cilin aplikon.*

### ***Afati i dorëzimit të dokumenteve (për të dy vendet e lira të punës):***

Pranimi i dokumenteve bëhet deri më datën 14.8.2024, ora 16:00. Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë të drejtën të konsultohen me njësinë përgjegjëse të personelit për plotësimin e dokumentacionit. Pas këtij afati nuk pranohet asnjë aplikim për këtë vend pune.

## **Mënyra e vlerësimit**

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me datën 18.9.2024 prej orës 10:00.

## **Verifikimi paraprak**

Rezultatet e verifikimit paraprak të kryer nga njësia, me emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret, do të shpallen më datë 9.9.2024 në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave, dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen nuk publikohet. Njësia i bën të ditur çdo kandidati veçmas arsyen e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse brenda 3 (tri) ditë pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditë pune nga data e depozitimit të saj.

## **Verifikimi i kandidatëve**

Kandidatët e kualifikuar duhet të paraqiten më datën 18.9.2024 për zhvillimin e konkursit pranë KPP.

## **Vlerësimi do të bëhet për:**

a). Arsimimin, kualifikimin e aktivitetin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin që gjendet në dosje; b). Intervistën me gojë; c). Projektin kërkimor..

Totali i pikëve në vlerësimin e kandidatëve është 100 (njëqind) pikë dhe ka këtë strukturë: a). 25 për qind për formimin profesional; b). 25 për qind për vlerësimin në bashkëbisedimin me gojë; c). 50 për qind për projektin kërkimor.

## **Fazat e konkurrimit:**

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a). Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe specifike të domosdoshme prej kandidatëve; b). Vlerësimi i kandidatëve.

## Shpallja e rezultateve dhe njoftimi i fituesit:

### *Verifikimi paraprak*

Rezultatet e verifikimit paraprak të kryer nga njësia, me emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret, do të shpallen më datë 9.9.2024 në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave, në rrjetet sociale të institucionit dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen nuk publikohet. Njësia i bën të ditur çdo kandidati veçmas arsyen e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse brenda 3 (tri) ditë pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditë pune nga data e depozitimit të saj.

### *Vlerësimi i kandidatëve*

Kandidatët e kualifikuar duhet të paraqiten më datën **18.9.2024** për zhvillimin e konkursit pranë KPP. Rezultati për çdo kandidat do të dalë nga shuma e pikëve të dhëna për të nga anëtarët e KPP. Në bazë të tyre do të përcaktohet renditja e kandidatëve.

Lista me emrat e konkurruesve me mbi 65 pikë do t'i dërgohet njësisë përgjegjëse të personelit e cila *shpall fitues të parin që renditet në listë*. Emri dhe profili profesional i fituesit *i njoftohen Kryesisë*. Kryetari i ASH bën emërimin në detyrë të fituesit. Fituesi brenda tri ditësh lidh kontratën e punës me institucionin të përfaqësuar nga Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë.

Njësia bën publik vendimin për emërimin përmes faqes zyrtare të institucionit.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë**

**Sheshi “Fan Noli”, Tiranë**

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)